



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të Ligjit nr. 03 / L - 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të Instruksionit për rishikimin e buxhetit të vitit 2017, të lëshuar nga Ministria e Financave, të dt. 03.05.2017 dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.05.2017, miratoi këtë

V E N D I M
P Ë R
RISHIKIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2017

I.

MIRATOHET Vendimi për rishikimin e buxhetit të vitit 2017.

II.

Qëllimi, në kuptim të pikës I të këtij vendimi, është që sipas rishikimit të buxhetit të vitit 2017, mjetet të ridestinohen në kategoritë buxhetore, sipas nevojave të Komunës, për: *mallra dhe shërbime, komunal, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale.*

III.

Ridestinimi i kategorive të cekura në pikën II të këtij vendimi, do të bëhet sipas shtojcës së bashkëngjitur këtij vendimi.

IV.

Zbatimin e këtij vendimit e bën Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtorja e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-401/03-0122850/17, më 25.05.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.